



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 1236 Prot

Lezhë, më 31.01 /2023

VENDIM

Nr. 3, Datë 31.01.2023

“PËR MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL VENDOR 2023-2025”

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” përcaktuan qartësisht detyrimin e Bashkisë për të identifikuar nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror, për ti planifikuar dhe ngritur këto shërbime. Bashkia Lezhë në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore për pushtetin vendor dhe shërbimet sociale ka zbatuar planin social vendor përgjatë viteve 2018-2021 ku ka përmbushur disa nga objektivat për fuqizimin e strukturave lokale të shërbimeve sociale. Bazuar në këtë eksperiment me mbështetjen e TDH Shqipëri, Bashkia Lezhë ka rishikuar dhe hartuar planin e ri social vendor për periudhën 2023-2025. Plani është një instrument i Bashkisë dhe strukturave lokale, për të garantuar në mënyrë të plotë përmbushjen e nevojave të kategorive vulnerabël në territorin e Bashkisë duke u siguruar atyre mbrojtje, përkujdesje dhe mundësi për gjithëpërfshirje në komunitet. Me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Social Vendor 2023-2025 dhe Kostimin e tij.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI  
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI  
NDUE LULI





BASHKIA LEZHË

# PLANI SOCIAL VENDOR 2023 -2025



*Rishikimi i planit social vendor 2023 -2025 për Bashkinë  
Lezhë u mbështet nga Terre des hommes Shqipëri in në kaudër të Child hub.*

## TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE .....	4
<i>Analiza e situatës dhe treguesit social</i> .....	4-9
VIZIONI, PARIMET DHE OBJEKTIVAT E PLANIT SOCIAL .....	10 -11
Parimet dhe vizionl .....	10
Objektivat .....	11
ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT.....	11-13
Zbatimi.....	11
Monitorimi dhe vlerësimi .....	11-12
MATRICA E PLANIT SOCIAL VENDOR 2023-2025.....	14- 48
Objektivi strategjik 1.....	14-31
Objektivi strategjik 2 .....	32-45
Objektivi strategjik 3.....	45-48
REFERENCAT.....	49-52

**LISTA E SHKURTIMEVE**

<b>MSHMS</b>	<i>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>
<b>DRSHS</b>	<i>Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social</i>
<b>TDH</b>	<i>Terre des hommes</i>
<b>VKM</b>	<i>Vendim i këshillit të ministrave</i>
<b>Nj.V.N.R</b>	<i>Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit</i>
<b>NJQV</b>	<i>Njësi e Qeverisjes Vendore</i>
<b>NJA</b>	<i>Njësi Administrative</i>
<b>DRP</b>	<i>Drejtoria Rajonale e punësimit</i>
<b>DSHS</b>	<i>Drejtoria e shërbimit Social</i>
<b>DRAP</b>	<i>Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar</i>
<b>NE</b>	<i>Ndihmë Ekonomike</i>
<b>PAK</b>	<i>Persona me Aftësi të Kufizuara</i>
<b>PIM</b>	<i>Plan Individual i Mbrojtjes</i>

## HYRJE

Bashkia Lezhë në kuadër të përmbushjes së detyrimeve ligjore për pushtetin vendor dhe shërbimet sociale ka zbatuar planin social vendor përgjatë viteve 2018-2021 ku ka përmbushur disa nga objektivat për fuqizimin e strukturave lokale të shërbimeve sociale. Bazuar në këtë eksperiment me mbështetjen e TDH Shqipëri, Bashkia Lezhë ka rishikuar dhe hartuar planin e ri social vendor për periudhën 2023-2025. Plani është një instrument i Bashkisë dhe strukturave lokale, për të garantuar në mënyrë të plotë përmbushjen e nevojave të kategorive vulnerabël në territorin e Bashkisë duke u siguruar atyre mbrojtje, përkujdesje dhe mundësi të për gjithëpërfshirje në komunitet.

Ligji nr.13/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" përcaktuan qartësisht detyrimin e Bashkisë për të identifikuar nevojat për shërbime të kujdesit shoqëror, për ti planifikuar dhe ngritur këto shërbime. Megjithatë Bashkia nuk është i vetmi aktor në adresimin e nevojave të këtyre grupeve, adresimi efektiv i të cilave kërkon domosdoshmërisht angazhim aktiv të të gjithë aktorëve lokalë përgjegjës sipas ligjit për problematikat sociale dhe pjesëmarrje aktive të grupeve të interesit në programimin dhe planifikimin e tyre në përputhje me nevojat specifike të të gjithë kategorive.

Plani social vendor 2023-2025 u përgatit pas një procesi të vlerësimit të nevojave i drejtuar nga Drejtoria e Shërbimit Social në Bashkinë Lezhë me grupet e interesit, ku përgjatë të cilit u identifikuan kategoritë në nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror në territorin e kësaj Bashkie, shërbimet që ata marrin aktualisht, si dhe nevojat për ngritjen e shërbimeve të reja të kujdesit shoqëror në këtë territor. Përgjatë vlerësimit të nevojave u identifikuan edhe nevojat për rishikimin e strukturave të Bashkisë lezhë për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Për kryerjen e vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror u përdor një kombinim i metodave të ndryshme të mbledhjes së të dhënave parësore dhe dytësore, specifikisht: rishikimi i të dhënave dytësore për të analizuar kontekstin ligjor kombëtar, si dhe strategjitë dhe planet e zhvillimit lokal; përcaktim dhe mbledhje e treguesve që identifikojnë kategoritë në nevojë dhe përcaktojnë madhësinë e tyre; intervista gjysëm të strukturuar me stafin e strukturës përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror për të identifikuar nevojat për strukturim, organizim dhe training të tij; fokus grupe me grupet e interesit që përfitojnë nga programet e mbrojtjes sociale, konsultimi me aktorët publik dhe jopublik lokal e rajonal në territorin e bashkisë.

## ANALIZA E SITUATËS DHE TREGUESIT SOCIAL

Bashkia Lezhë gjatë zbatimit të planit social vendor 2018-2021 ka arritur të përmbushi me sukses disa nga objektivat e vendosura si: 1) zhvillimi dhe ofrimi i shërbimeve të reja ku mund të përmendet ofrimi i shërbimit në banesë për fëmijët me aftësi të kufizuara, ofrimi i shërbimeve të emergjencës për viktimat e dhunës në familje, shërbime komunitare multidisiplinare për komunitetin rom dhe egjiptian; 2) *Fuqizimi i mekanizmave lokal në menaxhimin e rasteve në nevojë për mbrojtje* si Mekanizmi i Koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje, grupi teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve të cilët kanë menaxhuar me sukses me dhjetra raste çdo vit; 3) *Informimi dhe ndërgjegjësimi i aktorëve lokal dhe komunitetit mbi çështje të ndryshme sociale, mekanizmat ligjorë dhe shërbimet*

egzistuese nëpërmjet fushatave dhe aktiviteteve informuese të vazhdueshme në të gjithë territorin e bashkisë.

Lidhur me kapacitet e strukturave të shërbimeve sociale në Bashkinë e Lezhës nga të dhënat e mbledhura nëpërmjet intervistave dhe focus grupeve me profesionistët rezultoi se **Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rasteve nuk janë ngritur ende edhe pse Bashkitë kanë detyrimin ligjor për ngritjen e tyre që prej vitit 2016<sup>1</sup>**. Ky ligj ka përcaktuar që në strukturat e shërbimeve sociale lokale duhet të ketë 1 Punonjës Social për çdo 6000 -10000 banorë<sup>2</sup>, të cilat rezultojnë që nuk janë krijuar në asnjë prej njësive administrative edhe pse ishte një nga objektivat e planit të parë. Njësitë Administrative të cilat potencialisht përmbushin kushtet për zbatimin e këtij standarti janë 5, përkatësisht NJA Lezhë, Shëngjin, Zejmen, Shënkoll, Balldre.

Sa i përket njësisë së mbrojtjes së fëmijëve **stafi është i pa plotësuar me specialist sipas standartit 1 PMF për 3000 fëmijë**.<sup>3</sup> Kjo ka sjellë mbingarkesë për numrin e rasteve që mbulon çdo specialist, gjë që ndikon cilësinë dhe ndjekjen e vazhdueshme të rasteve në nevojë për mbrojtje. Njësitë të cilat kanë nevojë për shtim të kësaj strukture në 4 vitet e ardhëshme janë 5, përkatësisht: NJA Lezhë me 7600 femije; NJA Shënkoll me 4663 femije; NJA Shëngjin me 2862 fëmijë; NJA Balldre me 2517 fëmijë; NJA Zejmen me 2514 fëmijë.

**Ngritja dhe funksionimi i shërbimit të kujdesit për fëmijët pa kujdes prindëror në familje kujdestare ende nuk është realizuar sipas detyrimeve ligjore.**

Në tabelën në vijim paraqiten treguesit socialë në bashkinë e Lezhës të mbledhura nga burime të ndryshme lokale si Bashkia Lezhë, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria Rajonale e Punësimit, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, etj.

Treguesi	Niveli i disagregimit		Burimi dhe viti i mbledhjes së të dhënave
1.Të dhëna sociale të përgjithshme			
1.1Papunësia			
Papunësia/Punëkërkuar të papunë	Total	889	Burimi: Raporti i DRP Lezhë Viti: Prill 2022
	Sipas gjinisë	femra 508 meshkuj 381	
Sipas moshës:	Mbi 50 vjeç	315	Burimi: Raporti i DRP Lezhë Viti: Prill 2022
	45-50 vjeç	90	
	40-44 vjeç	104	
	35-39 vjeç	150	
	30-34 vjeç	75	
	25-29 vjeç	50	
	20-24 vjeç	80	
	15-19 vjeç	25	

<sup>1</sup> Ligji Nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë".

<sup>2</sup> Ibid

<sup>3</sup> Ligji Nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës".

Sipas arsimit	Më pak se fillore	92	
	Fillore	65	
	9 vjeçare	451	
	E mesme e përgjithshme	242	
	E mesme profesionale	107	
	Arsim universitar	34	
Të papunë sipas target grupeve	<b>Sipas moshës:</b>		<b>Burimi:</b> Raporti i DRP Lezhë <b>Viti:</b> Prill 2022
	Punëkërkues Romë	17	
	Punëkërkues Egjiptianë	116	
	Punëkërkues viktime të trafikimit	0	
	Punëkërkues me AK	5	
	Punëkërkues emigrantë të kthyer	6	
<b>1.2 Arsimi</b>			
Niveli Arsimor			
<b>Shkolla 9 – Vjeçare</b>	<b>Nr i nxënësve</b>	<b>Nr i mësuesve</b>	<b>Burimi:</b> DRAP Lezhë <b>Viti akademik</b> Shtator 2021-2022 <b>Burimi:</b> DRAP Lezhë <b>Viti akademik</b> Shtator 2021-2022
26	5251	446	
<b>Shkolla Fillore</b>	<b>Nr i nxënësve</b>	<b>Nr i mësuesve</b>	<b>Burimi:</b> DSHS <b>Viti:</b> Shtator 2021-2022
1	63	7	
<b>Shkolla të Mesme të Bashkuara</b>	<b>Nr i nxënësve</b>	<b>Nr i mësuesve</b>	<b>Burimi:</b> Bashkia Lezhë <b>Viti:</b> 2022
11	2080	232	
<b>Shkolla të Mesme të Përgjithshme:</b>	<b>Nr i nxënësve</b>	<b>Nr i mësuesve</b>	
	1253	84	
<b>Shkolla Profesionale</b>	<b>Nr i nxënësve</b>	<b>Nr i mësuesve</b>	
1	459	45	
Nr. i përfituesve PAK			
Nr. i përfituesve PAK	<b>Sipas kategorisë:</b>		<b>Burimi:</b> DSHS <b>Viti:</b> Nëntor 2022
	Të verbër	245	
	Para-tertaplegjik	195	
	PAK mendor dhe fizik	1547	
	<b>Fëmijët sipas grupmoshës:</b>		
	0- 6 vjeç	95	
	6 - 15 vjeç	164	
	15- 18 vjeç	110	

<b>3.Shërbimet e kujdesit shoqëror</b>	<b>Total:</b> Nr. i popullsisë: 114500		<b>Burimi:</b> DSHS <b>Viti:</b> Nëntor 2022
Sipas llojit të shërbimeve	Nr. i përfituesve të shërbimeve shoqërore: 874 (0,8% e popullsisë)  Nr. i përfituesve PAK: 4667 përfitues (4.1 % e popullsisë);  Nr. i përfituesve të shërbimeve për të moshuarit: 140 përfitues (0.12 % e popullsisë);  Nr. i përfituesve të shërbimeve për fëmijët: 369 përfitues (0.32% e popullsisë);  Nr. i përfituesve të shërbimeve për gratë e dhunuara dhe viktimat e trafikimit: 81 përfitues (0.07%) <b>Shërbime për të moshuarit:</b> 1 qendër ditore për të moshuarit; <b>Shërbime për fëmijët:</b> 2 qendra rezidenciale jopublike; 4 qendra ditore jopublike; <b>Shërbime për PAK:</b> 1 qendër ditore publike; 0 qendra ditore jopublike; <b>Shërbime për gratë e dhunuara dhe viktimat e trafikimit:</b> 1 qendër rezidenciale emergjence jopublike; 0 qendër ditore jopublike;  <b>Shërbime për të rinjtë</b> 1 qendër ditore jopublike;		Burimi: DSHS  <b>Viti:</b> 2022
Nr. i përfituesve	Total	<b>1159</b>	
<b>3.1 Fëmijët</b>			
	<b>405 fëmijë</b> Komunitar jopublik	<b>29 fëmijë</b> Rezidencial Jopublik	
<b>3.2 Gratë</b>			
	Sipas llojit të	Rezidenciale	



	shërbimit	jopublike <b>10 gra dhe vajza</b> Komunitar jopublik <b>1000 gra</b>	
<b>3.3 Të moshuarit</b> Numri dhe lloji i shërbimeve për të moshuarit			Burimi: DSHS  Viti: 2022
	Sipas llojit të shërbimit	1 shërbim ditor jopublik  110 përfitues të shërbimit ditor jopublik.	
Nr. të moshuarve përfitues	Total	<b>110</b>	
	Sipas gjinisë	Femra 10 Meshkuj 100	
	Sipas moshës		
<b>3.4 FËMIJËT me AK</b> Nr. dhe lloji shërbimeve për fëmijët me AK	Total 369 fëmijë me AK	Sipas Grupmoshës 0-6 vjeç 95 Fëmijë 6-15 vjeç 164 fëmijë 15-18 vjeç 110fëmijë	Burimi: DSHS  Viti: 2022
	1 qendra ditore publike		
	Sipas llojit të shërbimit	<b>30 përfitues – Ditor publik;</b>	
Nr. i Shërbimeve për komunitetet Rome dhe Egjiptiane	3 qendër Ditore jopublike 100 përfitues anëtarë të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane		Burimi: DSHS  Viti: 2022
<b>3.6 Shërbime për të rinjtë</b>		1 Qendër ditore jopublike 300 përfitues	Burimi: DSHS  Viti: 2022

Nga analiza e treguesve dhe konsultimet me grupet e interesit rezultojnë që kanë nevojë për mbështetje të vazhdueshme me shërbime multidisiplinare personat me aftësi të kufizuara, të

moshuarit e vetmuar, gratë dhe fëmijët në nevojë për mbrojtje, komuniteti Rom dhe Egjyptian dhe të rinjtë në rrezik.

**Plani social vendor për 4 vitet e ardhëshme do të fokusohet në:**

1. Përmirësimin e funksionimit të strukturave të shërbimeve sociale, me qëllim organizimin në përputhje me parashikimet ligjore për rolet dhe funksionet që duhet të ketë struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.
2. Fuqizimin e mëtejshëm të koordinimit ndërinstitucional në menaxhimin e rasteve në nevojë, pasi identifikimi, referimi dhe menaxhimi i rasteve kërkon veprim të koordinuar të një numri aktorësh publik dhe jopublik, përfshirë edhe ofruesit e shërbimeve të kujdesit shoqëror.
3. Fuqizimin dhe ngritjen e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në përputhje me nevojat e identifikuarra për shërbime. Fuqizimi dhe ngritja e tyre do të jetë graduale përgjatë periudhës tre vjeçare të zbatimit të këtij plani.
4. Informimin e komunitetit vendor mbi shërbimet e kujdesit shoqëror dhe rrugët se si ti aksesojnë këto shërbime, për të nxitur identifikimin e rasteve të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje dhe për ti referuar tek strukturat përkatëse që kanë kapacitetet për të adresuar nevojat e tyre.

Bashkia Lezhë dhe TDH falenderojnë për bashkëpunimin të gjitha institucionet publike dhe jo publike në territorin e kësaj Bashkie dhe grupet e interesit për përfshirjen aktive në procesin e përgatitjes së Planit Social Vendor 2023 – 2025.

## VIZIONI, PARIMET DHE OBJEKTIVAT E PLANIT SOCIAL

### *Parimet*

Plani Social Vendor i Bashkisë Lezhë mbështetet në parimet më të rëndësishme të sanksionuara në legjislacionin kombëtar për mbrojtjen e shtresave të popullsisë në nevojë për mbrojtje:

- Mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia, feja, moshë, aftësitë e kufizuara, etj.
- Grupe të veçanta, përfshirë fëmijët, duhen të jenë subjekt i mbrojtjes së veçantë, bazuar në nevojat dhe të drejtat e tyre.
- Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm që të mbështesë zhvillimin maksimal të individëve.
- Individët janë përgjegjës për jetën e tyre dhe çdo shërbim duhet të respektojë parimin e pavarësisë dhe autonomisë së tyre.
- Koordinimi i strukturave qendrore, qeverisjes rajonale dhe vendore, si dhe partnerë të tjerë në komunitet.
- Vendimarrja në nivel vendor udhëhiqet nga standartet kombëtare.

### *Vizioni*

Bashkia Lezhë synon të fuqizojë një sistem vendor të mbrojtjes e përkujdesjes sociale të fokusuar tek nevojat e individit dhe familjes për ti mbrojtur, fuqizuar dhe riintegruar në jetën ekonomike sociale përmes ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror që janë pjesë e një sistemi të integruar dhe funksional shërbimesh në territorin e Bashkisë dhe ndërveprues me sistemet rajonale e kombëtare.

### *Objektivat*

Planit Social Vendor i Bashkisë Lezhë është i ngritur mbi tre objektiva strategjike të ndërlidhura me njëra tjetrën dhe që përbushja e secilës kontribon në përbushjen e vizionit të këtij institucioni për shërbimet e kujdesit shoqëror.



## ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT

### Zbatimi

Plani është parashikuar të zbatohet për një periudhë katër vjeçare dhe për çdo aktivitetet është përcaktuar koha e zbatimit, për përcaktimin e së cilës janë mbajtur në konsideratë dy faktorë:

1. Prioriteti i ndërhyrjes, në përputhje me vlerësimin e kryer të nevojave.
2. Kostoja e çdo aktiviteti dhe shpejtësia e ngritjes së fondeve.

Ndërhyrjet me kostot më të larta, kryesisht ngritja e shërbimeve komunitare, janë parashikuar të ndodhin në vitin e dytë, të tretë dhe të katërt të planit, duke përdorur vitin e parë jo vetëm për fuqizimin dhe përgatitjen e strukturave lokale, si dhe të kushteve për ngritjen e rrjetit të shërbimeve të kujdesit shoqëror, por edhe për të konsoliduar fondin social lokal të Bashkisë Lezhë me fonde kryesisht nga Bashkia, qeveria qendrore dhe donatorë.

Në plan është përcaktuar për çdo aktivitet njësi/stafi zbatues i aktivitetit specifik. Edhe pse zbatimi i planit është përgjegjësi e drejtpërdrejtë e Bashkisë, partneriteti me institucione (që kanë përgjegjësi ligjore në zbatimin e një aktiviteti specifik është pasqyruar në këtë Plan. Gjithsesi zgjerimi i këtij partneritetit me organizata/ofrues të tjerë do të mbetet detyrë e vazhdueshme e strukturës përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashkinë Lezhë.

Plani do të jetë objekt rishikimi çdo vit veçanërisht në funksion të atyre aktiviteteve për të cilat duhet të mbahen në konsideratë zhvillimet afatshkurtra lokale dhe nevojat koherente të individëve në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.

## ***Monitorimi dhe vlerësimi***

Për efekt të monitorimit dhe vlerësimit për çdo aktivitet të Planit është parashikuar njësi/të përgjegjëse për monitorimin e çdo aktivitetit, ndërkohë që për çdo aktivitet është përcaktuar lista e treguesve që lehtësojnë procesin e monitorimit dhe vlerësimit sasior dhe cilësor të çdo aktiviteti.

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit do të jetë verifikimi sesa efektiv ka qenë zbatimi i aktiviteteve, a janë përmbushur në mënyrë të sukseshme objektivat strategjike dhe specifike të planit dhe mbi të gjitha çfarë ndikimi ka pasur zbatimi tek individët në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje.

Procesi i monitorimit dhe vlerësimit duhet të kalojë përmes:

- a) Mbledhjes së të dhënave;
- b) Analizimit të të dhënave;
- c) Raportimit të tyre;

Mbledhja e të dhënave dhe e informacionit të nevojshëm për matjen e treguesve të përcaktuar është një etapë thelbësore e procesit të monitorimit. Këto të dhëna do të përdoren për të vlerësuar nëse aktivitetet e planifikuara janë zbatuar në praktikë sipas specifikimeve përkatëse të Matricës së Planit (në sasinë dhe cilësinë e parashikuar), sikurse të dhënat e mbledhura do të japin pamje të qartë mbi arritjet dhe problematikat që kanë dalë gjatë zbatimit të Planit.

Të dhënat e mbledhura dhe të analizuar do të jenë bazë e Raportit njëvjeçar. Raporti do të shërbejë gjithashtu edhe për të rishikuar ato elementë të Planit trevjeçar që marrin një fokus të ri për shkak të arritjeve dhe problematikave të identifikuara në periudhën një vjeçare.

Gjatë periudhës së zbatimit do të kryhet një vlerësim i cili do të influencojnë drejtpërdrejt riorganizimin dhe riformulimin e objektivave specifike dhe aktiviteteve për periudhën e mbetur, specifikisht:

- 1 vlerësim në mes të periudhës së zbatimit të planit dhe Raporte vjetore (fund i 2023, fund i 2024). Këto raporte do shërbejnë edhe për të rishikuar Planin e Veprimit për vitin pasardhës.
- Vlerësimi dhe Raporti përfundimtar (fund i 2025). Ky raport do të shërbejë edhe për të përgatitur Planin pasardhës afatmesëm të Bashkisë.

Në përfundim të fazës përgatitore të këtij Plani stafi i strukturës përgjegjëse të shërbimeve të kujdesit shoqëror do të trainohet edhe për komponentin e monitorimit dhe vlerësimit me qëllim që të ketë kapacitetin për ta zhvilluar këtë proces të rëndësishëm. Ndërkohë vetë përfituesit e aktiviteteve të zbatuar në kuadër të këtij plani do të kenë zë në vlerësimin e tyre, pasi parashikohet konsultim i buxhetit dhe Planit Social Vendor të Bashkisë me fëmijët, gratë, personat me aftësi të kufiuara, të moshuarit dhe grupe të tjera në nevojë.

### ***Monitorimi dhe vlerësimi i jashtëm***

Bazuar në detyrimet ligjore, shumë prej aktiviteteve të përfshira në Plan Veprimi janë subjekt i monitorimit, kontrollit apo inspektimit nga institucione kombëtare si: Agjensia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektoriati Shëndetësor dhe i Mbrojtjes Sociale. Rezultatet e kontrolleve, monitorimeve apo inspektimeve do të mbahen gjithashtu në konsideratë gjatë procesit të vlerësimit të Planit nga struktura përgjegjëse e shërbimeve të kujdesit shoqëror të Bashkisë Lezhë.

# MATRICA E PLANIT SOCIAL VENDOR

2023-2025

OBJEKTIVI STRATEGJIK 1 – FUQIZIMI I STRUKTURAVE TË SHËRBIMEVE TË KUJDESIT SHOQËROR DHE KOORDINIMIT NËRINSTITUCIONALE NË MENAXHIMIN E RASTEVE

AKTIVITETET	AKTORËT PËRGJEGJËS	AFATI	TREGUESIT	BURIMI I DHËNAVE	BURIMI I KOSTO FINANCIMIT	MONITORIMI
<b>Objektivi 1: Riorganizimi strukturor dhe funksional i strukturave të shërbimeve të kujdesit shoqëro në përputhje me detyrimet ligjore</b>						
Aktiviteti 1.1: Ngritja e NJVNR, plotësimet strukturore dhe rishikim i përshkrimeve të punës.	Drejtoria e shërbimeve sociale	2023-2024	Njësia Vlerësimit Nevojave Referimit organizuar numër funksione sipas parashikimeve ligjore;	Ligji e shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë	Bashkia Lezhë	Nënkryetari i Bashkisë
Aktiviteti 1.1.1 Ngritja e NJVNR në NJJA Qendër/Lezhë				Ligji "Për vetqeverisjen vendore		
Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura:			Rregullorja e Bashkisë Lezhë përmban përshkrim të ri pune për	Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"		
o punonjës social - 1 (shitesë)					4,113,600	
o administrator shoqëror				Ligji "për		

<p>1 (shtesë)</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>o punonjës për mbrojtjen e fëmijëve -1 (shtesë)</li> </ul> <p><b>Aktiviteti 1.1.2: Ngritja e NJVNR në NJA Shëngjin</b>  Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>o punonjës social - 1 (shtesë)</li> </ul> <p><b>Aktiviteti 1.1.3 Ngritja e NJVNR në NJA Zejmen</b>  Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>o punonjës social - 1 (shtesë)</li> </ul> <p><b>Aktiviteti 1.1.4 Ngritja e NJVNR në NJA Shënkoll</b>  Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>o punonjës social - 1 (shtesë)</li> <li>o punonjës i mbrojtjes së fëmijës – 1 (shtesë)</li> </ul>			<p>strukturën e Nj.V.N.R në NJA dhe specialisti sipas parashikimeve ligjore;</p>	<p>ndihmën ekonomike" Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare"</p>	<p>1,980,000</p> <p>660,000</p> <p>5,280,000</p>	
--	--	--	--	--	--	--



<ul style="list-style-type: none"> <li>o administrator shoqëror 1(shtesë)</li> </ul> <p><b>Aktiviteti 1.1.5 Ngritja e NJVNRnë NJA Balldre</b> Rishikim i përshkrimit të punës dhe struktura:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>o punonjës social 1(shtesë)</li> </ul>						1,980,000	
<p><b>Objektivi 2: Ngritja e kapaciteteve të strukturave të shërbimeve të kujdesit shoqëror në përputhje me funksionet që përmbushin</b></p>							
<p><b>Aktiviteti 2.1. Trainime për stafin e strukturës të shërbimeve të kujdesit shoqëror në Bashki.</b> Trainimet do të zhvillohen në përputhje me nevojat e identifikuara për gatë planifikimit të planit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>o Planifikimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror;</li> <li>o Monitorimi dhe vlerësimi;</li> <li>o Konsultimet me aktorët kryesorë;</li> <li>o Puna me shërbimin</li> </ul>	Drejtoria e shërbimeve sociale	2023 2024 2025	Numri i trainimeve të zhvilluara përputhje me fushat identifikuar për ngritje kapacitetesh; Numri i pjesëmarrësve në trainim në përputhje me rolin funksionin që kanë; Praktika pune të	Ligji i shërbimit të kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” Ligji “Për vetqeverisjen vendore Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në	Bashkia Lezhë Partneritet me institucione në nivel kombëtar (SHSSH) dhe organizata joqeveritare	6,720,000	Nënkryetari i Bashkisë

<p>jopublik, krijim rrjeti komunikimi dhe bashkëpunimi për ofrim shërbimesh dhe referime rastesh urgjente;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>o Prokurimi i shërbimeve të kujdesit social;</li> <li>o Hartimi i projekteve;</li> <li>o Buxhetimi i shërbimeve sociale.</li> </ul>			<p>përmirësuar në vijim trainimeve rezultateve të kapaciteteve të rritura shprehive fituara nga trainimet;</p>	<p>marrëdhënien familjare" Ligji "për ndihmën ekonomike" Ligji "Për të drejtën e informimit publik" Ligji "Për prokurimin Publik"</p>			
<p>Aktiviteti 2.2. Trainim i stafëve të NJVNR</p> <p><b>Trainimet do të zhvillohen në përputhje me nevojat e identifikuar:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>o Njohuri mbi paketën legjislativë të shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe mbrojtjes së grupeve vulnerabël.</li> <li>o Teknika të menaxhimit të rasteve sociale.</li> <li>o Trainime specifike të punonjësve të mbrojtjes së fëmijëve për detyrimet që rrjedhin nga Ligji "Për</li> </ul>	<p>Drejtoria e shërbimeve sociale</p>	<p>2023-2024</p>	<p>Numri i trainimeve të zhvilluara në përputhje me fushatat identifikuar për ngritje kapacitetesh; Numri i pjesëmarrësve në trainim në përputhje me rolin dhe funksionin që kanë; Praktika pune të përmirësuar në vijim të trainimeve si rezultat i kapaciteteve të</p>	<p>"Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligji "Për vetqeverisjen vendore Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare"</p>	<p>Bashkia Lezhë në partneritet me institucione publike në nivel kombëtar (SHSSH) dhe organizata joqeveritare me ekspertizë në fusha specifike;</p>	<p>3,840,000</p>	<p>Nënkryetari i Bashkisë</p>

<p>të Drejtat dhe Mbrojtjen e fëmijës" dhe shërbimin e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>o <i>Trainim i punonjësve social në mënyrë të veçantë për çëshijet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore.</i></li> </ul>		ritura shprehive fituara trainimet;	dhe të nga	Ligji "Për të drejtën e informimit publik"	"për ndihmën ekonomike"						
<p><b>Objektivi specifik 3: Ngritja e infrastrukturës fizike dhe teknike të punës së strukturave të shërbimeve të kujdesit shoqëror në të dy nivelet</b></p>											
<p>Aktiviteti 3.1: Përmirësimi i paketës me formularët dokumentimit që lidhen me menaxhimin e rasteve sociale dhe procedurat e referimit tek shërbimet e kujdesit shoqëror.</p>	<p>Paketa përgatitet nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale në përputhje me kërkesat ligjore dhe u dërgohet me udhëzimet përkatëse NJVNR</p>	<p>Gjithashtu përgatitet e</p>	<p>Drejtoria e shërbimeve sociale</p>	<p>2023-2024</p>	<p>Numri i formularëve të përgatitur sipas parashikimeve ligjore për çdo grup në nevojë për shërbime; Paketa e dërguar zyrtarisht pranë NJVNR.</p>	<p>Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM specifike që rrjedhin prej tij.</p>	<p>Bashkia Lezhë</p>	<p>168,960</p>	<p>Nënkryetari i Bashkisë</p>		

<p>dërgohet edhe adresari me të gjitha kontaktet e sistemit të referimit dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror.</p>				<p>Vendimi i Këshillit Ministrave për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në përmbrojtje</p> <p>Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare" dhe VKM specifike në zbatim të tij.</p> <p>Ligji "Për ndihmën ekonomike"</p>	<p>Bashkia Lezhë</p>	<p>Nënkryetari i Bashkisë</p>
<p>Aktiviteti 3.2. Përmirësimi i infrastrukturës fizike të punës në përputhje me nevojat për menaxhimin e rasteve sociale.</p> <p><i>Këtu përfshihen ndërhyrjet infrastrukturore si në ambientet e punës së Sektorit të ndihmës ekonomike dhe shërbimeve shoqërore,</i></p>	<p>Drejtoria e shërbimeve sociale</p>	<p>2023-2025</p>	<p>Ambientet e punës janë të përshatshme për përmbushjen e detyrave funksionale dhe detyrimeve ligjore;</p> <p>Mjedisi miqësor për fëmijët;</p> <p>Mjedisi i sigurt për viktimat e dhunës në</p>	<p>"Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe VKM specifike që rrjedhin prej tij.</p> <p>"Për vetqeverisjen vendore"</p> <p>"Për të</p>	<p>2,100,000</p>	

<p><b>ashtu edhe të NJVNR.</b></p> <p><b>Specifikisht:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>o Ambientet e punës së pajisura sipas nevojave të punës së staffit.</li> <li>o Ambient i përshatur për nevojat e punës me fëmijët (mjedis miqësor për fëmijët apo konfidencial për viktimat e dhunës me bazë gjinore).</li> <li>o Ambiente të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara.</li> <li>o Ambient miqësor për çdo individ në nevojë.</li> </ul>			<p>familje; Mjedis miqësor dhe aksesueshem për çdo individ në nevojë; Stafi administron dokumentacionin në përputhje me parashikimet ligjore;</p>	<p>drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare" dhe VKM specifike në zbatim të tij.</p>	
<p><b>Objektivi 4: Monitorimi i situatës së kategorive vulnerabël dhe rishikimi periodik i Planit Social Vendor</b></p>					
<p>Aktiviteti 4.1. Përcaktimi dhe plotësimi i treguesve që identifikojnë kategoritë në nevojë dhe mbledhja periodike e të dhënave</p>	<p>Drejtoria e shërbimeve sociale</p>	<p>e 2023-2024</p>	<p>Lista e treguesve që do të mbliohen;</p>	<p>Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" dhe</p>	<p>Bashkia e Lezhë 276,480 Nënkryetari i Bashkisë</p>

<p><b>Struktura përgjegjëse:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>o identifikon treguesit që duhet të mbliiden</li> <li>o institucionet dhe ofruesit e shërbimeve nga duhet të merren të dhënat</li> <li>o frekuencën e mbledhjes së të dhënave</li> <li>o I drejtohet zyrtarisht me kërkesë bashkëpunim për qëllime të mbledhjes së të dhënave të gjitha institucioneve të identifikuar dhe ofruesve të shërbimeve</li> </ul>	<p>Drejtoria e shërbimeve</p>	<p>2023 2024</p>	<p>Analiza e Vlerësimit të</p>	<p>“Për Ligji shërbimet e Bashkia Lezhë</p>	<p>Nënkryetari i Bashkisë</p>
					<p>675,840</p>
				<p>VKM specifike që rrjedhin prej tij.</p> <p>Ligji "për vetqeverisjen vendore"</p> <p>Ligji "për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"</p> <p>Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare" dhe VKM specifike në zbatim të tij.</p>	
			<p>Institucionet dhe ofruesit shërbimeve nga do të sigurohet mbledhja e të dhënave; Treguesit mbledhur në mënyrë periodike;</p>		

<p>Vendor Struktura përgjegjëse kryen analizë periodike multisektoriale të grupeve në nevojë për shërbime në territorin e Bashkisë, mbi bazë e të dhënave të mbledhura nga zbatimi i aktivitetit 4.1</p> <p>Mbi bazën e treguesve që matin zbatimin e çdo aktiviteti të parashikuar në Planin Social kryen vlerësimin e zbatimit të aktiviteteve të Planit një herë në vit</p> <p>Mbi bazën e treguesve statistikor të analizuar, rezultateve të montiorimit të aktiviteteve dhe konsultimeve me grupet vulnerabël, drejton punën për rishikimin e Planit Social Vendor.</p>	<p>sociale</p>	<p>2024 2025</p>	<p>Nevojave të kryer; Plani Social Lokal i rishikuar çdo vit;</p>	<p>kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë dhe VKM specifike që rrjedhin prej tij. Ligji "për vetqeverisjen vendore" Ligji "për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve" Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare" dhe VKM specifike në zbatim të tij.</p>	<p>Bashkia Lezhë</p>	<p>345,600</p>	<p>Nënkryetari i Bashkisë</p>
<p>Aktiviteti 4.3. Konsultim i buxhetit dhe Planit Social Vendor të Bashkisë me fëmijët, gratë, persona me aftësi të kufizuara dhe grupe</p>	<p>Drejtoria e shërbimeve sociale</p>	<p>2023 2024 2025</p>	<p>Numri i konsultimeve të zhvilluara me fëmijët; Numri i konsultimeve të</p>	<p>Ligji "për shërbimet e kujdesit shoqëror" Ligji "për mbrojtjen dhe të</p>	<p>Bashkia Lezhë</p>	<p>345,600</p>	<p>Nënkryetari i Bashkisë</p>

<p>në nevojë.</p>			<p>zhvilluara me gratë; Numri i konsultimeve të zhvilluara me persona aftësi të fkuziara dhe grupe në nevojë; Ndryshimet e ndodhura në planet dhe buxhetin lokal sipas propozimeve të marra nga konsultimet e zhvilluara;</p>	<p>drejtat e fëmijës" Ligji "për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare " Ligj "për të drejtën për informim"</p>		
<p><b>Objektivi 5: Zhvillimi i qasjes ndërsektoriale në menaxhimin e rasteve sociale</b></p>						
<p>Aktiviteti 5.1. Takime të vazhdueshme informuese të stafit të NJVNR me institucione lokale për të nxitur identifikimin referimin e rasteve sociale tek kjo strukture.</p>	<p>Njësia Vlerësim të Nevojave dhe Referimit (të gjitha)</p>	<p>2023 2024 2025</p>	<p>Numri i takimeve informuese të zhvilluara; Numri i pjesëmarrësve në takimet e zhvilluara; Përbajtja e</p>	<p>Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligji "Për vetqeverisjen</p>	<p>Bashkia Lezhë</p>	<p>675,840 Drejtoria shërbimeve sociale</p>



<p>Takimet do të zhvillohen me Drejtues dhe mësues të shkollave në territorin e Bashkisë; Sistemin shëndetësor; Gjyqtarë e prokurorë; Polici; Ofrues të shërbimeve lokale;</p> <p>Takimet do të synojnë t'i informojnë mbi shërbimet e NjVNR dhe shërbimet sociale në tërësi me qëllim referimin e rasteve të mundshme të individëve në nevojë për mbështetje.</p>			<p>materialeve dhe mesazheve të komunikimit përmëbushin e qëllimet takimeve; Numri i rasteve që referohen nga institucione të ndryshme në vijim të takimeve në sajë të rritjes së të kuptuarit të funksionimit të mekanizmit të referimit tek shërbimet sociale;</p>	<p>vendore" Ligji "për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijës" Ligji "për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare "</p>		1,843,200	Drejtoria e shërbimeve sociale Administratori i Njesisë Administrative
<p>Aktiviteti 5.2. Punonjësit e NjVNR menaxhojnë në mënyrë efektive rastet sociale në nevojë për mbrojtje duke kryer:</p> <p>Vlerësimin Fillear dhe trajtim të rasteve emergjente; Vlerësimin e Plotë; Planifikimin e Mbrojtjes dhe Përkujdesit;</p>	<p>Njësia e Vlerësimit Nevojave dhe Referimit (të gjitha)</p>	<p>2023 2024 2025 Vazhdimisht sipas rasteve të referuara</p>	<p>Numri i rasteve të referuara; Numri i rasteve të menaxhuara; Numri i individëve të referuar shërbimet sipas nevojës; Numri i individëve që janë informuar e</p>	<p>Ligji "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë" Ligji "Për vetqeverisjen vendore" Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e</p>	<p>Bashkia e Lezhë Grupet teknike ndërsektoriale</p>		

<p>Përgatitjen e dokumentacionit për marrjen e shërbimit komunitar/familje/rezidencial sipas kriterëve ligjorë Zbatimi, Monitorimi dhe Ndjekjen e Planit; Mbylljen e Rastit. Punonjësit e NJVNR sigurojnë pjesëmarrjen e individit dhe familjes përgjatë çdo hapi të procesit të menaxhimit të rastit që nga identifikimi dhe deri tek mbyllja e rastit.</p>			<p>këshilluar nga stafi i NJVNR. Numri i individëve të asistuar nga stafi për përgatitjen e dokumentacionit me qëllim e përfitim të shërbimeve të kujdesit shoqëror; Numri i individëve të fuqizuar në saj të përpjekjeve të koordinuara të drejtuara nga NJVNR.</p>	<p>fëmijëve” Ligji “Për masa ndaj dhunës në marrëdhënien familjare” Ligji “Për ndihmën ekonomike”</p>			
<p><b>Objektiv 6: Fuqizimi i koordinimit dhe qasjes ndërsektoriale për mbrojtjen e fëmijëve</b></p>							
<p>Aktiviteti 6.1. Fuqizimi mëtejshëm i Grupit Ndërsektorial ad hoc, në nivel drejtuesish të institucioneve vendore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve.</p>	<p>Njësia e Mbrojtjes Fëmijës</p>	<p>2023 2024 2025</p>	<p>Numri i takimeve të zhvilluara; Numri i drejtuesve të institucioneve pjesëmarrës në takim;</p>	<p>Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”</p>	<p>Bashkia Lezhë</p>	<p>921,600</p>	<p>Nënkryetari i Bashkisë</p>

<p>Kryetari i Bashkisë drejton takime të paktën një herë në 4 muaj të grupit.</p> <p>Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës Raporton mbi funksionimin e sistemit të mbrojtjes dhe referimit, koordinimin ndërinstitucional, si dhe situatën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në territorin e Bashkisë</p>			<p>Minutat e takimeve të zhvilluara; Numri i raporteve të prezantuara në secilin takim; Nisma të përbashkëta të ndërmarra dhe praktika pune ndërinstitucionale të përmirësuara;</p>	<p>Ligji "Për të drejtat e mbrojtjen e fëmijëve"</p>	<p>Bashkia Lezhë Strukturat, arsimore, shëndetësore, policia, prokuroria, gjykatat, ofruarit e shërbimeve</p>	<p>Nënkryetari i Bashkisë Drejtoria e shërbimeve sociale</p>
